

## Maj 2016

### Reforma në Sektorin e Ujit

#### Kryeministri Edi Rama Takohet me Përfaqësues të Pushtetit Vendor për të Diskutuar Reformën e Sektorit të Ujit



Ditën e premte, 29 prill, Kryeministri Edi Rama u takua me përfaqësues të pushtetit vendor për të diskutuar mbi fazën e dytë të reformës në sektorin e ujit. Kryeministri u ndal

gjerësisht në reformën në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Më poshtë është fjala e plotë e Kryeministrit Rama, marrë nga faqja zyrtare e kryeministrit. “Ky është një takim që ka një rëndësi të veçantë për faktin se sot, qeveria shqiptare, në bashkëpunim me të gjithë drejtuesit vendorë çel fazën e dytë të Reformës Kombëtare të Ujit. Është një nga reformat e mëdha që ka kërkuar një fazë relativisht të gjatë përgatitore nën drejtimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe me mbështetjen e Këshillit Kombëtar dhe Sekretariatit Kombëtar të Ujit, për të hyrë në këtë fazë të dytë, ku është e domosdoshme që sëbashku të fillojmë të jetësojmë këtë reformë, që njësoj si disa reforma të mëdha të qeverisë sonë është e vonuar prej 20 e kusur vitesh. [lexo më shumë](#)

#### Ministria Organizon Takime Rajonale për të Dhënë Udhëzime mbi Reformat e Sektorit të Ujit



Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës drejtoi katër Takime Rajonale gjatë mesit të muajit prill në qytetin e Lezhës, Tiranë, Pogradec



### Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

### Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike!

2-3-4 Nëntor 2016,  
Tiranë, Shqipëri

Eventet e  
Ardhshme

dhe Vlorë për të siguruar një mundësi për kryetarët e bashkive, zyrtarët e bashkive dhe drejtorët e shoqërive UK të kuptojnë më mirë objektivat e Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 63, i datës 27 janar 2016, me titull “Për Riorganizimin e Operatorëve që Ofrojnë Shërbimin e Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullimin, Largimin dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura”. [lexo më shumë](#)

## Lajme nga Anëtarët tanë

### UKT në Bashkëpunim me USAID, Gati për një Sistem të Ri Faturimi



Bashkia e Tiranës dhe Ujësjetës Kanalizime Tiranë përballen sot me sfidën e modernizimit të sistemeve të administrimit e menaxhimit të të ardhurave dhe tarifave vendore si

dhe të shërbimeve vendore për qytetarët. Sistemet ekzistuese kanë rezultuar me mangësi dhe probleme të mprehta dhe janë krejtësisht të pamjaftueshme e të papërshtatshme për të përballuar situatën e re që ka sjellë për qeverisjen vendore zbatimi i reformës territoriale. [lexo më shumë](#)

## Të tjera

### SHUKALB Ftohet të Ndajë Përvojën e Saj në Konferencën e Bosnje Herzegovinës



SHUKALB u ftua nga organizatorët e një Konference një ditore në Zenica, Bosnje dhe Herzegovinë (BH), më 30 mars, me temë “Nga Sfidat te Mundësitë”. Objektivi i përgjithshëm i

Konferencës, që u organizua nga Aquasan Network BiH ishte promovimi i standardeve më të larta për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve dhe nevojave të ujit, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në kompanitë publike të shërbimeve (PUC) dhe njësive vetë-qeverisëse lokale (NJVL), si dhe nevoja për të ngritur një kornizë legjislative mbështetëse të përmirësuar në sektorin e shërbimeve të ujit në BH dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. [lexo më shumë](#)

- Manaxhimi i Aseteve - 06  
Maj 2016

**Bashkohuni me Ne!**



**Na tregoni se cfarë mendoni!**



## SHUKALB Dërgon Specialistë për të Marrë Pjesë në Kursin “Trajnimi i Trajnerëve” në Shkup



Përmes përpjekjeve të saj në rrjetin e shoqatave dhe programeve të tjera në Ballkanin Perëndimor, SHUKALB pati mundësinë të kishte tre specialistë si pjesëmarrës në një “Trajnim për Trajnerët (TT)” në Shkup për “Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura “. Specialistët ishin Arbana Kola, Specialiste për Zhvillimin e Kurseve nga Projekti i Zhvillimit të Kurseve të Trajnimit të SHUKALB, si dhe Esida Lekbello dhe Ervin Bucpapaj, të cilët janë trajnerë në kursin e SHUKALB mbi “Reduktimin e Humbjeve të Ujit”. [lexo më shumë](#)

## IFAT 2016: 30 Maj – 3 Qershor, Mynih, Gjermani – Panairi Kryesor në Botë i Tregtisë për Ujë, Kanalizimin dhe Menaxhimin e Ujërave të Ndotur dhe Lëndëve të Papërpunuara



IFAT është Panairi Kryesor në Botë i Tregtisë për Ujë, Kanalizimin dhe Menaxhimin e Ujërave të Ndotur dhe Lëndëve të Papërpunuara, dhe është një vend ku vizitorët mund të informohen rreth strategjive dhe zgjidhjeve për përdorimin e burimeve në cikle inteligjente në një mënyrë të tillë që siguron ruajtjen e tyre afatgjatë – me një leverdi të lartë. [lexo më shumë](#)

---

## Trajnime dhe Mundësi Arsimimi

### Edicioni i 19-të i Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike | Torino, Itali | 05-16 shtator 2016

**Shkolla e Rregulloreve Lokale të Torinos** njofton se ka fhapur zyrtarisht aplikimet për Edicionin e 19-të të **Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike**.

Shkolla Verore u drejtohet studentëve të vitit të fundit, studentëve të diplomuar dhe zyrtarëve të Administratës Publike (bashkive, prefektuarave, organeve rajonale) dhe

agjencive rregullatore.

Pjesëmarrësit që do të përzgjidhen do të mund të përfitojnë nga tarifat shumë të ulëta të regjistrimit; regjistrim falas për vendet jo anëtare të OBEZH (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) siç është Shqipëria dhe shteteve të anëtarësuaras rishitaz në BE. Regjistrimi përfshin 2 javë **akomodim falas** në Torino.

Aplikimet janë të hapura. Afati: **5 qershor 2016**.

Për informacion të mëtejshëm dhe formën e aplikimit ndiqni linkun: [www.turinschool.eu/iss](http://www.turinschool.eu/iss)

---

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

**Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë,**

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

**E-mail:** [info@shukalb.al](mailto:info@shukalb.al), **Web:** [www.shukalb.al](http://www.shukalb.al)